

KOMITETIT PARALIMPIK TË KOSOVËS

Nr. Fiskal / NRB : 600747416

Numri i regjistrimit : 5113569-5

Raporti i Auditori i Pavarur dhe Pasqyrat Financiare
për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR.....	3
DEKLARATA E PAJTUESHMËRISË.....	5
I. Pasqyra e pozitës financiare	6
II. PASQYRA GJITHËPËRFSHIRSE E TË ARDHURAVE.....	7
III. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË FONDE	8
IV. PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË.....	9
V. Shënimet për “Pasqyrat Financiare”.....	10

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për menaxhmentin e OJQ KOMITETIT PARALIMPIK TË KOSOVËS

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të OJQ "KOMITETIT PARALIMPIK TË KOSOVËS" ("Organizata"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2025, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që përfundon me këtë datë, si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Organizatës me datën 31 dhjetor 2025, si dhe rezultatin e veprimtarisë dhe flukset e parasë për vitin që përfundon në këtë datë, në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM-të), të aplikuar për aq sa është i zbatueshëm për Organizatat Jo-qeveritare, si dhe me kërkesat ligjore dhe rregullative të zbatueshme për Organizatat Jo-qeveritare në Republikën e Kosovës.

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare" të këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me kërkesat etike të Kodit të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës (IESBA) dhe me kërkesat përkatëse ligjore në Republikën e Kosovës, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Raport mbi Kërkesa të Tjera Ligjore dhe Rregullative

Në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, Organizata është subjekt i kërkesave për raportim dhe transparencë financiare ndaj Zyrës së Regjistrimit dhe Mbikëqyrjes së OJQ-ve.

Gjithashtu, Organizata dorëzon raporte specifike në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-116, i cili ndryshon dhe plotëson Ligjin Nr. 05/L-090 lidhur me sponsorizimet në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative të aplikueshme për Organizatat Jo-qeveritare, duke përfshirë Ligjin Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asocimit në Organizatat Jo-qeveritare, si dhe kërkesat përkatëse tatimore dhe rregullative në fuqi në Republikën e Kosovës.

Informacione të Tjera, të Ndryshme nga Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë formë konkluzioni që jep siguri mbi këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse ato përmbajnë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare ose me njohuritë e fituara gjatë auditimit, ose nëse përndryshe paraqesin anomali materiale. Nëse, bazuar në punën e kryer, arrijmë në përfundimin se ekziston një anomali materiale në informacionet e tjera, ne jemi të detyruar ta raportojmë këtë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë drejtim.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me bazën e raportimit financiar të zbatueshme për Organizatat Jo-qeveritare, si dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Organizatës për të vazhduar veprimtarinë në vijimësi, për shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me vijimësinë, si dhe për përdorimin e parimit kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur menaxhmenti synon likuidimin e Organizatës ose ndërprerjen e veprimtarisë, ose kur nuk ekziston ndonjë alternativë tjetër reale.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria

e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të zbulojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, pritet në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale të pasqyrave financiare, dizajnojmë dhe kryejmë procedura auditimi në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë;
- marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të rëndësishëm për auditimin, me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Organizatës;
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti;
- nxjerrim një përfundim mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vijimësisë nga menaxhmenti, bazuar në evidencën e auditimit të siguruar;
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shpalosjet, si dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë që sigurojnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, ndër të tjera, lidhur me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, si dhe për gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme të kontrollit të brendshëm të identifikuar gjatë auditimit.

Pavarësia dhe Etika

Ne konfirmojmë se jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës të IESBA-s, Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, si dhe aktet nënligjore përkatëse në fuqi, dhe se kemi përmbushur të gjitha përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Vega Audit SH.P.K.
No.Licencës:39

Nexhit Shala, auditor ligjor
Nënshkrimi
No.Licencës:99

16 shkurt 2026




Emri i organizatës	KOMITETIT PARALIMPIK TË KOSOVËS
Lloji organizatës	OJQ
Numri I regjistrimit	5113569-5
NRF:	600747416
Adresa:	Tabet e Lapashticës nr 35/11

DEKLARATA E PAJTUESHMËRISË

(Deklaratë e Menaxhmentit)


Bazuar në njohuritë tona më të mira dhe në përgjegjësinë tonë profesionale, ne deklarojmë se pasqyrat financiare të OJQ "KOMITETIT PARALIMPIK TË KOSOVËS", për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025, paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të vërtetë pozicionin financiar të Organizatës, rezultatin e veprimtarisë së saj, si dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në këtë datë, në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM-të), të aplikuar për aq sa është i zbatueshëm për Organizatat Jo-qeveritare, si dhe me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asocimit në Organizatat Jo-qeveritare dhe aktet nënligjore përkatëse në fuqi në Republikën e Kosovës.


Njomza EMINI

Kryetare

KOMITETIT PARALIMPIK TË KOSOVËS




Lulzim Beqiri

Zyrtar financiar, kontabilist i certifikuar

Prishtinë
20 janar 2026

I. PASQYRA E POZITËS FINANCIARE

Euro	Shënimet	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parësë	4	-	1,166
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	45,000	-
Pasurite Tjera	6	-	-
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		45,000	1,166
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	7	8,400	12,600
Gjithsej pasuritë afatgjata		8,400	12,600
Gjithsej pasuritë		53,400	13,766
DETYRIMET DHE FONDET			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	8	49,350	4,600
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër		-	47,951
Te hyrat e shtyera		8,400	12,600
Detyrimet e tjera afatshkurtra	9	16,152	-
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		73,902	65,151
Detyrimet afatgjata			
Gjithsej detyrimet afatgjata		-	-
Gjithsej detyrimet		73,902	65,151
FONDET			
Fondi themelues i organizatës (kumulativ)	10	-	-
Tëpricat / (Mungesat) e vitit	14.b	(20,502)	(51,384)
Rezervat e tjera		-	-
Gjithsej fondet		(20,502)	(51,384)
Gjithsej fondet dhe detyrimet		53,400	13,766

Këto pasqyra financiare janë aprovuar për publikim më 20 janar 2026 dhe nënshkruar nga:


Njomza EMINI
Kryetare

KOMITETIT PARALIMPIK TË KOSOVËS




Lulzim Beqiri
Zyrtar financiar, kontabilist i certifikuar

Shënimet shoqëruese nga 10 deri 15 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

II. PASQYRA GJITHËPËRFSHIRSE E TË ARDHURAVE

Euro	Shënimi	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024
Të ardhura nga donacionet dhe subvencionet	11	223,057	235,638
Te hyrat sipas memorandumit	11	60,000	60,000
Te hyrat e shtyera	12	4,200	4,200
Gjithësej të hyrat		287,257	299,838
Shpenzimet e pagave	13.a	82,629	128,107
Shpenzimet per projekt	13.b	123,340	133,056
Shpenzimet operative	13.c	50,406	97,855
Gjithësej shpenzimet		256,375	359,018
Shpenzimet financiare	13.d	-	-
Të ardhurat financiare		-	-
Gjithësej të hyrat/shpenzimet financiare		-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim	14	-	-
Gjithësej shpenzimet e tatimit ne fitim		-	-
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:			
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave			
financiare te operacioneve të huaja, neto nga tatimi		-	-
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit		-	-
Diferenca Pozitive/Negative e periudhës		30,882	(59,180)

III. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË FONDE

	Fondi €	'epricat / (mungesat) €	Rezervat e tjera €	Gjithsej €
Gjendja më 31 dhjetor 2023	-	7,796	-	7,796
Tepricat / (mungesat) e vitit	-	(59,180)	-	(59,180)
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	-	(51,384)	-	(51,384)
Tepricat / (mungesat) e vitit	-	30,882	-	30,882
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2025	-	(20,502)	-	(20,502)

IV. PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

Euro	Shënimi	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi / (humbja) i / e vitit		30,882	(59,180)
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		-	4,200
		30,882	(54,980)
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera		(45,000)	3,591
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe		-	-
(Rritja) / zvogëlimi në detyrimet e shtyera		-	(4,200)
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera		44,750	(7,673)
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera		16,152	(10,245)
		46,784	(73,507)
Tatimi në fitim i paguar		-	-
Interesi i paguar		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		46,784	(73,507)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		-	-
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë		(47,951)	47,951
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		(47,951)	47,951
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		1,166	26,723
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit		-	1,166

V. SHËNIMET PËR "PASQYRAT FINANCIARE"

për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025
(me shifra krahasuese për vitin 2024)

1. Të përgjithshme

OJQ "Komiteti Paralimpik i Kosovës" KPK ("Organizata") është asociacion i pavarur sportiv i cili bashkon të gjitha federatat dhe asociacionet sportive të personave me aftësi të kufizuara.

Themeluesit e Organizatës janë:

- Daut Tishuki Rruga "Azem Bejta" nr.35 Pejë.
- Igballe Potera, Rr. "Nënë Tereza" Ulpianë A2/15 Prishtinë.
- Aziz Nishori Rr."Gjergj Fishta" Nr.9 Lipjan.

Qëllimet e KPK-së janë: Organizimi, promovimi, shumëfishimi dhe zhvillimi në mënyrë cilësore i sporteve për para sportistët, zhvillimi i garave zyrtare dhe të tjera dhe marrja pjesë në Lojërat Paralimpike.

Organizata vepron në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asocimit në Organizatat Jo-qeveritare dhe aktet nënligjore përkatëse.

2. Baza e përgatitjes dhe shpalosje të përgjithshme

Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM / IFRS for SMEs), të aplikuar për aq sa është i zbatueshëm për Organizatat Jo-qeveritare, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative në fuqi në Republikën e Kosovës për raportimin e OJQ-ve.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në baza **akruale** dhe kryesisht mbi bazën e **kostos historike**.

Sistemi i kontabilitetit dhe mbajtja e evidencave financiare

Organizata mban evidencat e saj financiare kryesisht në mënyrë manuale dhe aktualisht nuk përdor një program të dedikuar të kontabilitetit. Regjistrimi i transaksioneve financiare realizohet përmes regjistrave manualë, tabelave ndihmëse dhe dokumentacionit mbështetës përkatës.

Menaxhmenti ka vendosur procedura dhe kontrole alternative për të siguruar që transaksionet financiare regjistrohen në mënyrë të plotë dhe të saktë, si dhe që pasqyrat financiare të përgatiten në përputhje me bazën e raportimit financiar të zbatueshme.

Menaxhmenti vlerëson se mungesa e një sistemi të automatizuar të kontabilitetit nuk ka ndikuar materialisht në saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare për periudhën raportuese.

Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur me supozimin se Organizata do të vazhdojë veprimtarinë e saj në të ardhmen e parashikueshme (parimi i vijimësisë).

Valuta funksionale dhe raportuese

Valuta funksionale dhe raportuese e Organizatës është **Euro (EUR)**.

Miratimi i standardeve të reja dhe të rishikuara

Gjatë periudhës raportuese, Organizata ka miratuar standardet e reja, të ndryshuara ose të rishikuara dhe interpretimet përkatëse që kanë qenë relevante për aktivitetin e saj dhe në fuqi për periudhën raportuese. Miratimi i tyre nuk ka rezultuar në ndryshime materiale në politikat kontabël të Organizatës.

Gjykimet kritike dhe burimet kyçe të pasigurisë së vlerësimit

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon përdorimin e gjykimeve, vlerësimeve dhe supozimeve që ndikojnë në shumat e raportuara të asetëve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Këto vlerësime rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën historike dhe pritjet për ngjarjet e ardhshme. Fushat kryesore ku kërkohen vlerësime kontabël përfshijnë, ndër të tjera, **provizionet për dëmtim të të arkëtueshmeve**, si dhe **përcaktimin e jetëgjatësisë së dobishme të pronës, impianteve dhe pajisjeve**. Bazuar në

vlerësimin e menaxhmentit, nuk janë identifikuar gjykime kritike apo burime kyçe të pasigurisë së vlerësimit që do të kishin ndikim material në shumat e njohura në pasqyrat financiare.

3. Politikat kontabël sipas zërave

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paratë në arkë dhe depozitat bankare të përdorshme menjëherë. Ekuivalentët e parasë përfshijnë investime afatshkurtra shumë likuide (kur janë relevante) me maturim origjinal zakonisht deri në tre (3) muaj, që janë lehtësisht të konvertueshme në para dhe kanë rrezik të parëndësishëm të ndryshimit në vlerë.

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Të arkëtueshmet njihen fillimisht në vlerën e faturuar dhe më pas maten me kosto të amortizuar, minus provizionin për dëmtim. Organizata vlerëson në çdo datë raportimi ekzistencën e treguesve të mosarkëtimit dhe krijon provizion sipas pritjes së rikuperimit.

Prona, impiantet dhe pajisjet (PPE)

Prona, impiantet dhe pajisjet regjistrohen me kosto historike, minus amortizimin e akumuluar dhe, kur është e nevojshme, humbjet nga rënia në vlerë. Kostoja përfshin shpenzimet që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së asetit.

Amortizimi llogaritet me metodën drejtëvizore mbi jetën e dobishme të vlerësuar si vijon:

- Pajisje dhe inventar: 5 vite
- Pajisje IT: 5 vite

Fondi neto / Fondi i Organizatës

Fondi i Organizatës përfaqëson interesin e Organizatës në pasuritë neto dhe përbëhet nga fondi themeltar dhe tepëricat/mungesat e bartura, si dhe rezultati i periudhës. Organizata nuk shpërndan fitim dhe fondet përdoren vetëm për qëllime statutores.

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

Të pagueshmet njihen fillimisht në vlerën e faturuar dhe më pas maten me kosto të amortizuar. Për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër, zakonisht nuk diskontohen.

Të hyrat

Të hyrat njihen kur është e mundur që përfitimet ekonomike do të rrjedhin në Organizatë dhe kur ato mund të maten në mënyrë të besueshme. Të hyrat përfshijnë kryesisht tarifën e anëtarësisë, tarifën për trajnim dhe aktivitete sportive, si dhe donacionet/grantet (kur janë të aplikueshme) sipas kushteve të tyre.

Shpenzimet operative

Shpenzimet njihen në periudhën kur ndodhin, në bazë akruale, dhe klasifikohen si shpenzime programore dhe shpenzime administrative.

Përfitimet e punëtorëve

Organizata kontribuon në skemën e detyrueshme pensionale në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Organizata nuk ka detyrime shtesë pensionale përtej këtyre kontributeve.

Provizionet

Provizioni njihet kur Organizata ka një obligim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe kur është e mundur që do të kërkohej një rrjedhje e burimeve ekonomike për shlyerjen e këtij obligimi, si dhe kur shumat mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme.

Tatimi në të ardhura (CIT)

Organizata është një organizatë jo-qeveritare jo-fitimprurëse dhe, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, **nuk është subjekt i tatimit në të ardhura për aktivitetet jo-komerciale**, të cilat lidhen drejtpërdrejt me qëllimet statutores të saj.

Në rast se Organizata realizon të ardhura nga aktivitetet komerciale, këto të ardhura trajtohen në përputhje me **Ligjin Nr. 06/L-105 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave**, përkatësisht dispozitat që rregullojnë trajtimin tatimor të të ardhurave komerciale të organizatave jo-qeveritare, si dhe aktet nënligjore përkatëse.

Tatimi i shtyrë

Organizata nuk njihet tatim të shtyrë, pasi nuk ka diferenca të përkohshme materiale ndërmjet bazës kontabël dhe bazës tatimore të aseteve dhe detyrimeve.

Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)

Trajtimi i TVSH-së për aktivitetet e Organizatës bëhet në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, duke marrë parasysh natyrën e aktiviteve të saj dhe dispozitat përkatëse që rregullojnë lirimet dhe/ose kufizimet e së drejtës për zbritjen e TVSH-së.

Grantet dhe donacionet që lidhen me pasuritë

Grantet dhe donacionet e marra për financimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve njihen në përputhje me politikën kontabël të Organizatës dhe kërkesat e SNRF për NVM-të, të aplikuara për atë që janë të zbatueshme për Organizatat Jo-qeveritare.

Grantet që lidhen me pasuritë paraqiten si të ardhura të shtyra dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë sistematike dhe racionale gjatë jetës së dobishme të pasurisë përkatëse, në përputhje me amortizimin e asetit të financuar.

Arkëtimi i granteve dhe blerja e pasurive përkatëse paraqiten në pasqyrën e fluksit të parasë si flukse investuese dhe financuese, sipas natyrës së transaksionit.

4. PARAJA E GATSHME DHE LLOGARITË BANKARE

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paranë në arkë dhe depozitat bankare të përdorshme menjëherë. Gjendja e parasë në datën e bilancit është si vijon:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
	(në Euro)	(në Euro)
Paraja në arkë	-	-
Paraja në bankë	-	1,166
Total	-	1,166

5. LLOGARITË E ARKËTUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
	(në Euro)	(në Euro)
Kërkesat ndaj memorandumit	45,000	-
Parapagimet e dhena	-	-
Huazimet	-	-
Total	45,000	-

6. (Nëse ka) DONACIONET / GRANTET

7. PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

	Automjetet	Inventari	Pajisjet	Total
Kosto historike				
Më 1 janar 2024	21,000	-	-	21,000
Shtesat gjatë vitit	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2024	21,000	-	-	21,000
Shtesat gjatë vitit	-	-	-	-
Heqjet nga përdorimi	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2025	21,000	-	-	21,000
Zhvlerësimi i akumuluar:				
Më 1 janar 2024	4,200	-	-	4,200
Zhvlerësimi për vitin	4,200	-	-	4,200
Më 31 dhjetor 2024	8,400	-	-	8,400
Zhvlerësimi për vitin	4,200	-	-	4,200
Heqjet nga përdorimi	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2025	12,600	-	-	12,600
VLERA NETO E ASETEVE				
Më 31 dhjetor 2024	12,600	-	-	12,600
Më 31 dhjetor 2025	8,400	-	-	8,400

8. LLOGARITË E PAGUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
	(në Euro)	(në Euro)
Detyrimet ndaj furnitorëve	49,350	4,600
Parapagimet e Marra	-	-
Tjera	-	-
Total	49,350	4,600

9. DETYRIMET TË TJERA

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
	(në Euro)	(në Euro)
Detyrimet ndaj pagave	-	-
Pensionet	5,159	-
Tatimi ne paga	10,496	-
Tatimi ne qira	496	-
Total	16,152	-

10. FONDI NETO (FONDI I ORGANIZATËS)

11. TË HYRAT

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Te Hyrat -Donacione	180,000	243,638
Te Hyrat - Donacione Vetura	4,200	4,200
Te Hyrat e Bartura nga Viti Paraprak	-	-8,000
Te hyrat per fedaratat sipas memorandumit	60,000	60,000
Sponzorizimi	30,000	-
Të Hyra nga Institucionet- Zyra e Presidentes	1,000	-
Të Hyra Donacion BIRK	1,000	-
Kthim Komiteti Poloni	1,276	-
Të hyra të tjera	9,781	-
Totali i të Hyrave	287,257	299,838

12. TË HYRAT TË TJERA

13. SHPENZIMET

13.a SHPENZIMET E PAGAVE BRUTO

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Pagat	68,438	106,179
Kontributi penzional	7,441	11,901
TAP mbajtur ne burim	6,750	10,027
Total	82,629	128,107

13.b Shpenzimet e Projekteve

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Projekti i Trajnimeve	-	-
Projekti	51,143	35,689
Federatat sipas memorandumit	60,000	60,000
Shërbime të Kontraktuara	12,197	37,367
Meditje	-	-
Total	123,340	133,056

13.c Shpenzime Operative

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Blerje, energji, avull, uje	-	185
Sherbime kontabiliteti Dhe Auditimi		2,600
Qira	6,000	6,552
Shpenzime Zyre	2,700	2,568
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	80	373
Shpenzimet e Karburant		
Reprezentacioni dhe udhetime jasht vendi		38,823
Shpenzime për shërbimet bankare	440	982
Shpenzime transpoti	32,489	16,022
Paisje	250	
Taksa e regjistrimit dhe trajnimeve		25,550
Mirëmbajtje, Riparime	113	
kthim I mjeteve te pashpenzuara 2024	4,134	
Shpenzime te ndryshme		
Shpenzimet e zhvleresimit	4,200	4,200
Total	50,406	97,855

14. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Palët e lidhura përfshijnë anëtarët e bordit/drejtuesit dhe personat kyç të menaxhimit. Gjatë periudhës, transaksionet me palët e lidhura përbëhen kryesisht nga paga/kompensime (nëse ka) dhe shpenzime të rimbursuara (nëse ka).

15. KONTINGJENTET DHE ZOTIMET

Zotime kapitale: Organizata nuk ka zotime kapitale materiale të kontraktuara në datën e bilancit.
Detyrime kontingjente: Me 31 dhjetor 2025, Organizata nuk është e përfshirë në çështje gjyqësore materiale nga aktiviteti i rregullt.

16. NGJARJET PASUESE

Nuk ka pasur ngjarje pas datës së bilancit që kërkojnë rregullim ose shpalosje shtesë në pasqyrat financiare.